

Migel Hidi ka përfunduar studimet e tij në Fakultetin Ekonomik, në degën e Financave, në Universitetin “Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi”.

Në prill 2024 deri në shtator, ka punuar si Inspektor Rajonal Jugor në Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Më herët, ka mbajtur një rol të rëndësishëm si Drejtor i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse në ASCKSHSH, ku ka menaxhuar financat dhe burimet njerëzore, si dhe ka kontribuar në zhvillimin e punës në sektorin e tij.

Ka qenë i angazhuar si Asistent i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Kryeministri dhe në auditimin e subjekteve në varësi të Kryeministrit duke luajtur një rol të ngjashëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në periudhën 2013-2018, ai ka punuar si Asistent i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, ku ka mbajtur përgjegjësi të ngjashme për menaxhimin e dokumentacionit dhe marrëdhënieve institucionale.

Me një përvojë të gjerë në sektorin privat, ka punuar si Merchandiser dhe Supvizor Promocionesh në kompani të njohura si “Interlogistic” dhe “Marketing & Distribution”. Ai ka qenë përgjegjës për menaxhimin e fushatave promociionale dhe ruajtjen e marrëdhënieve me klientët, duke e bërë atë të njohur për aftësitë e tij të shkëlqyera në analizën e tregut dhe zhvillimin e strategjive të marketingut.